

**SHPALLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS**

Tabela .1

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervista	Fillimi	Mbarimi
1	<b>Specialist</b>	Reparti Ushtarak nr.6026, AKMC	Tiranë	6 - mujore	Po	Po	16.06.2020	18.06.2020

Formulari nr. 1

<b>1.Pozicioni i punës:</b> Specialist, në Sektorin (Qendra) Kombëtare e Trajnimit për Mbrojtjen Civile, Edukimit dhe Vullnetarizimit, në Drejtorinë e Edukimit, Trajnimit dhe Teknologjisë së Informacionit.
<b>2. Kodi i pozicionit:</b> N/A
<b>3. Reparti/Institucioni:</b> Reparti Ushtarak Nr.6026, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
<b>4. Vendi:</b> Tiranë
<b>5. Paga:</b> VKM nr.47, datë 22.01.2020, i ndryshuar, IV-b.
<b>6. Lloji i kontratës së punës:</b> 6 - mujore
<b>7. Data e fillimit të aplikimit:</b> 16.06.2020
<b>8. Data e mbylljes së aplikimit:</b> 18.06.2020
<p><b>9. Mënyra e aplikimit:</b></p> <p>Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes, në adresën <a href="http://www.mod.gov.al">www.mod.gov.al</a>. Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës,do të dërgohet në: Drejtorinë e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve</p> <p>Ministria e Mbrojtjes, Rruga e Dibrës</p> <p>Tiranë</p>

## 10. Dokumentet e aplikimit:

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- kërkesën;
- formularin e aplikimit;
- fotokopje të kartës së identitetit;
- diplomën e shkollës së lartë të noterizuar sëbashku me listë notash;
- fotokopje të patentës nëse ka;
- dëshmi profesioni nëse ka;
- certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja
- raport mjekësor;
- fotografi me përmasa 4x6, 2 copë dhe 9x12 2 copë;
- dëshmi penaliteti;
- vërtetim nga gjykata;
- vërtetim nga prokuroria;
- librezë pune;
- jetëshkrimin (CV).
- Letër motivimi
- formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike [www.mod.gov.al](http://www.mod.gov.al) (linku: *Baza ligjore/Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetdeklarimit*)

## 11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

- a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- b) të jetë jo më pak se 18 vjeç;
- c) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kriterëve të miratuara;
- ç) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;
- e) të mos jetë i/e dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerje të një krimi;
- dh) të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

**12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:**

- |                                       |   |
|---------------------------------------|---|
| a. Grada/Titulli:                     | Specialist  |
| b. Arsimi :                           | Arsim të lartë Ushtarak/ Policor, Shkenca Edukimi, Shkenca Sociale, Shkenca Ekonomike, arsim i lartë në fushën e Mbrojtjes/Emergjencave Civile. |
| a. Kualifikimi:                       | Cikli i Dytë i Studimeve (Master profesional)   |
| b. Trajnimi:                          | Trajnim në fushën e kërkuar   |
| c. Eksperienca në Punë:               | Të ketë eksperiencë pune mbi 1 vit.   |
| d. Gjuha e huaj:                      | Anglisht  |
| e. Kërkesa të tjera specifike:        | Të ketë njohuri të mira në fushën e kërkuar.  |
| f. Niveli i certifikatës së sigurisë: | Konfidencial  |

**Përshkrimi i punës:**

**Deklarimi i pozicionit:** Përgjigjet për Mbrojtjen Civile, Edukimit dhe Vullnetarizmit, për hartimin dhe zbatimin me profesionalizëm të programeve të trajnimit, edukimit dhe informimit, me qëllim përgatitjen dhe rritjen e aftësive të komunitetit dhe strukturave të sistemit të mbrojtjes civile.

**Detyrat kryesore:**

1. Merr pjesë në hartimin e programeve të trajnimit për strukturat shtetërore, subjektet private e vullnetarët, për përgatitjen dhe rritjen e aftësisë në parandalimin dhe përgjigjen ndaj situatave të emergjencës civile apo fatkeqësive.
2. Merr pjesë në hartimin e programeve të edukimit dhe ndërgjegjësimit në fushën e parandalimit e përballimit e fatkeqësive.
3. Ndjek zhvillimin e trajnimeve për personelin e mbrojtjes civile në nivel qendror dhe vendor, në fushën e masave të zvogëlimit të riskut, planifikimit, parandalimit, reagimit dhe riaftësimit në rastet e emergjencave civile apo fatkeqësive.
4. Organizon fushata të informimit e ndërgjegjësimit për masat që duhet të merren për parandalimin e përballimit e fatkeqësive, dhe fushata promovuese për studimet dhe hulumtimet në parashikimin e parandalimit e rreziqeve natyrore ose të lidhura me veprimtarinë njerëzore.
5. Kryen testimin e skemave dhe rritjet të lajmërimit të personelit të angazhuar në fushën e mbrojtjes civile, si dhe sistemin e paralajmërimit të hershëm të publikut nëpërmjet testeve periodike.
6. Bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse për fushën e arsimit, për hartimin e programeve të edukimit në fushën e reduktimit të riskut të fatkeqësive dhe mbrojtjes civile, dhe përfshirjen e tyre në programet mësimore.  
Bashkëpunon me strukturat homologe të huaja dhe vendase në fushën e trajnimit, edukimit dhe informimit në fushën e mbrojtjes civile.

### 13. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë, e cila do të behet **ONLINE**.

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia e Burimeve Njerëzore verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit. Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen:

- a. 40 pikë, për vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve;
- b. 60 pikë, për intervistën e strukturuar me gojë.

**Vlerësimi i dokumenteve** të kandidatëve përfshin:

- a. vlerësimin ejetëshkrimin (CV);
- b. vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike;
- c. vlerësimin e trajnimeve;
- d. vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës;

Pikët totale të vlerësimit të dokumenteve ndahen, si më poshtë:

- a. jetëshkrimi, 5 pikë;
- b. arsimimi/kualifikimi, 15 pikë;
- c. trajnimi, 5 pikë;
- d. eksperiencia/përvoja në punë, 15 pikë.

**Intervista** e cila do të behet **ONLINE**, zhvillohet me gojë me të gjithë kandidatët që janë përzgjedhur gjatë fazës së përzgjedhjes paraprake. Qëllimi i intervistës është të verifikojë aftësitë, motivacionin dhe aspiratat e çdo kandidati, si dhe përputhshmërinë e profilit profesional të kandidatit me pozicionin që do të mbulojë.

Intervista zhvillohet e strukturuar me qëllim që të sigurojë informacion të saktë rreth profilit profesional të kandidatëve. Ajo strukturohet në varësi të pozicionit që punonjësi do të mbulojë dhe eksperiencës.

Gjatë intervistës kandidatit i drejtohen disa pyetje nga anëtarët e komisionit, përgjigjet e të cilave vlerësohen me pikë. Çdo pyetje ka një sasi të caktuar pikësh, të cilat vlerësohen në varësi të përgjigjes. Në total intervista ka 60 pikë.

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.